



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:029951

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644374

KPPP.nr.1839/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbarimore të kreditorit Dogana e Kosovës, me seli në rr. “Rexhep Krasniqi”, në Prishtinë, kundër debitorit “BETA” SH.P.K., me seli në rr. “Bulevardi Bill Klinton” pn., në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” SH.P.K., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Aktvendimit për Caktimin e Përmbarimit E.nr.2185/2011, të datës 13.02.2020, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, jashtë seancës me datën 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “BETA” SH.P.K., i paraqitur kundër Aktvendimit për Caktimin e Përmbarimit E.nr.2185/2011, të datës 13.02.2020, të Gjykatës Themelore në Prishtinë.
- II. MBETET NË FUQI Aktvendimi për Caktimin e Përmbarimit E.nr.2185/2011, i datës 13.02.2020, i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

A r s y e t i m

Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Dogana e Kosovës, ka lëshuar Aktvendimin për Caktimin e Përmbarimit E.nr.2185/2011, të datës 13.02.2020, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarimor - Aktvendimit të Doganës së Kosovës K-nr. 08/715 të datës 11.11.2010, me të cilin është detyruar debitori që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të propozimit, t’ia paguaj kreditorit borxhin prej 5,000.00 € sipas aktvendimit të lartcekur, si dhe shpenzimet e përmbarimit dhe shpenzimet e ardhshme, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, me ndalimin e mjeteve në para të cilat i

ka debitori në xhirollogari dhe bartjen e shumës përkatëse në xhirollogarinë e kreditorit, si dhe me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të cilat gjinden në banesë ose në lokalin afarist të tij dhe nga shitja e këtyre mjeteve të realizohet borxhi i kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ndër të tjerash ka theksuar se e kundërshton në tërësi aktvendimin me të cilin është lejuar përmbarimi, pasi që aktvendimi 08/715 i datës 11.11.2010 i kreditorit është bërë i formës së prerë me datë 10.11.2011, ashtu që në kuptim të nenit 43 par. 1 të Ligjit Nr. 05/L-087 Për Kundërvajtje, ekzekutimi është kërkuar pas më shumë se 1 viti që nga koha kur aktvendimi nr. 08/715 është bërë i formës së prerë, ndërsa sipas nenit 43. par. 6 të Ligjit për Kundërvajtje, atëherë aktvendimi i Doganës së Kosovës ka arritur edhe parashkrimin absolut me datë 10.11.2013. Më tutje ka shtuar se meqenëse Kodi Doganor dhe i Akcizave nuk parasheh çështjen e parashkrimit të ekzekutimit të kundërvajtjeve doganore, atëherë në këtë rast duhet të aplikohen dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-087 Për Kundërvajtje.

I ka propozuar gjykatës që të miratohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, të shfuqizohet si i pabazuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë E.nr.2185/11 i datës 13.02.2020, si dhe të detyrohet kreditori që t'i paguajë debitorit shpenzimet e përpilimit të prapësimin në shumën prej 104.00 €.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor, përkatësisht Aktvendimin Nr.05/562 të datës 11.11.2010, në bazë të së cilit është caktuar përmbartimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret rezulton se Aktvendimi K-nr. 08/715 i datës 11.11.2010, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbartimor është i përshatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Po ashtu Aktvendimi K-nr. 08/715 i datës 11.11.2010, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmëris për përmbartueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbartueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimi K-nr. 08/715 i datës 11.11.2010, i nxjerrë nga Dogana e Kosovës, është bërë i formës së prerë me datë 05.10.2011 dhe i ekzekutueshëm me datë 10.11.2011.

Gjykata po ashtu vlerësoi pretendimin e debitorit se në rastin konkret kërkesa është parashkruar, mirëpo duke u bazuar në dispozitën e nenit 379 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve - (1978), me të cilin përcaktohet se: *“Të gjitha kërkesat që janë përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose me vendim gjyqësor të formës së prerë ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me anë të pajtimit para gjykatës ose organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë vjet dhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër parashkrimi.”*, gjeti se kreditori inicimin e procedurës përmbartimore sipas dokumentit përmbartues - Aktvendimit K-nr. 08/715 të datës 11.11.2010, i cili është bërë i ekzekutueshëm me datën 10.11.2011, e ka paraqitur me datën 16.11.2011, përkatësisht brenda afatit dhjetë vjeçar të përcaktuar në dispozitën lartcekur.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbartimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet aktvendimi për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar duke u bazuar në 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1839/23, datë 30.04.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.